



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 463/01-29979 dt. 29 Maj 2026

Në bazë të nenit 11, nenit 12 par.2 pika d, nenit 14 par.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008, të neneve 5,6,8 dhe 14 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënien në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunës, neni 4, neni 5 paragrafi 1.3, neni 6 dhe neni 13 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, Vendimit Nr. 08/2026 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026, nr. prot: 400/01-8274, dt. 26 Shkurt 2026, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale - *Parcela Komunale 4560-23 në sipërfaqen prej 6735m² e cila është e destinuar përmes procedurës së shprehjes së interesit*, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me date: dt. 29 Maj 2026, nxjerr këtë:

VENDIM

Nr. 31/2026

Mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale - Parcela Komunale 4560-23, në sipërfaqen prej 6735m² e cila është e destinuar për dhënien në shfrytëzim përmes procedurës së shprehjes së interesit

I. Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të sipërfaqes prej 6735m² e identifikuar me certifikatën e pronës me numër 4560-23 pronë Komuna Pejë cila është e destinuar **përmes procedurës së shprehjes së interesit** në afat prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite, sipas Vendimit Nr.08/2026 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2026, me numër protokolli 400/01-8274. dt. 26 Shkurt 2026.

Nr.	PRONARI Poseguesi	Nr. i Ngastrës	Emri i rrugës (lokacioni)	Sipërfaqja	Zona Kadastrale	Destinimi	Periudha
1.	Komuna Pejë	4560-23	Rr. "Gani Daci"	6735m ²	ZK Pejë	Përmes procedurës së shprehjes së interesit	99 vite

II. Pas plotësimit të kushteve ligjore komisioni për komunal për vlerësimin e ofertave do të inicioj procedurën e **shprehjes së interesit**, për zgjedhjen e ofertës më të favorshme për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale - parcela komunale 4560-23, pronë komunale në ZK Pejë në sipërfaqe prej 6735m², e cila është e destinuar për qiradhënie në afat prej nëntëdhjetë e nëntë (99) vite.

III. Për zbatimin e këtij Vendimi dhe dispozitave të ligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, obligohet që të kujdeset Komisioni Vlerësues, Drejtoria për Çështje Pronësore-Juridike.

IV. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:

MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

